



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 24.07.2024)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:40 dhe mbaroi në orën 14:47.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. Klodian Kurushi | <i>(anëtar)</i> |
| 3. Irena Plaku | <i>(anëtare)</i> |
| 4. Gentiana Muçaj | <i>(anëtare)</i> |
| 5. Ridvan Hado | <i>(anëtar)</i> |
| 6. Alban Toro | <i>(anëtar)</i> |
| 7. Markelian Koça | <i>(anëtar)</i> |
| 8. Yllka Rupa | <i>(anëtare)</i> |
| 9. Emona Muçi | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Fatmira Luli.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas njoftimit të bërë dhe krijimit të kuoromit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen “online”, mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 24.07.2024, e cila ka të bëjë me një pikë, shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, për të cilën është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit të përcaktuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për të relatuar këto akte.

Alban Toro: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor janë paraqitur dy kërkesa, përkatësisht të datës 19.07.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, e cila daton më 26.04.2024.

Në mënyrë individuale po trajtoj kërkesat përkatëse duke hedhur shortin për secilën nga këto gjykata. Po e filloj nga mënyra e regjistrimit, pra të datës 19.07.2024, po filloj me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila në këtë datë ka paraqitur një kërkesë për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, me anë të së cilës kërkon caktimin e një gjyqtari për të gjykuar çështje në trup gjykues, të parashikuar nga nenet 283/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal. Numri i kërkesës është 2689/1 dhe numri i çështjes 91.

Natyrisht që skema e transferimit të përkohshëm për caktimin e gjyqtarit është e pamundur për t'u aplikuar për shkak të ndalimit të pikës 8 të nenit 42 të ligjit nr. 96/2016 dhe në këto kushte, i vetmi mekanizëm i cili mund të aplikohet është ai i parashikuar nga vendimi i KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ku ai ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në aplikim të këtij akti rregullativ, nga ana jonë ju propozohet (nga ana e komisionit pra) të caktohet për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë normalisht duhet të plotësojnë kushtet minimale pra të kenë shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe të kenë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje do të jetë vetëm një.

Natyrisht kemi parashikuar dhe gjyqtarët të cilët kanë parandalim ligjor, që janë zoti {...}, znj. {...}, të cilët kanë pengesë ligjore; si dhe keni edhe një listë bashkëlidhur, e cila ka të pasqyruar nominalisht gjyqtarët e tjerë të cilët kanë pengesa ligjore për efekt të pjesëmarrjes në trupa gjykues pranë asaj gjykate.

Kështu që, duke reduktuar këta gjyqtarë të cilët kanë pengesa ligjore për të marrë pjesë në gjykim, ftoj stafin të organizojë hedhjen e shortit, në eventualitetin që edhe nga ana juaj nuk do të ketë ndonjë sugjerim apo vërejtje në lidhje me aq sa u relatua.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj administratën për hedhjen e shortit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 2689/1, gjyqtar i përzgjedhur Alfred Konomi.

Ilir Rusi: Falenderoj administratën!

Lejoj relatorin të vazhdojë me relatimin e çështjes tjetër.

Alban Toro: Po vijoj atëherë aty ku e lashë, me relatimin e kërkesës së dytë të paraqitur nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, e cila me datën 26.04.2024 ka paraqitur kërkesë për caktim gjyqtari. Numri i gjyqtarëve që kërkohet të delegohen janë 2 dhe gjykimi do të bëhet për çështjen në lidhje me akuzën e parashikuar për të cilën trajton “Prodhim e shitje narkotikësh. Në bashkëpunim, moskallëzim krimi, prerje e paligjshme e pyjeve, etj.”. Numri i kërkesës është 145. Numri i çështjes po 145.

Natyrisht skema e delegimit është e pamundur për t’u aplikuar për shkak të mungesës së gjyqtarëve në këtë skemë. Gjithashtu edhe mekanizmi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarit është i pamundur të aplikohet për shkak se dobia që sjell transferimi i gjyqtarit do të krijonte një efekt më shumë negativ sesa pozitiv, pasi ai do të duhet të dorëzonte çështje të cilat ai disponon në gjykatën ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, për të gjykuar një çështje të veçantë, gjë që dukshëm krijon efekte negative në administrimin e drejtësisë.

Kështu që i vetmi mekanizëm i parashikuar për të zgjidhur këtë situatë është ai i vendimit të KLGJ-së i cili parashikon rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Në këtë kontekst Komisioni propozon që gjykata nga duhet të përzgjidhen, do të jetë ajo e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Natyrisht numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e kësaj çështjeje do jetë 2 (dy).

Natyrisht është parashikuar që të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, i cili natyrisht ka edhe detyra të tjera të administrimit të kësaj gjykate.

Nëse nuk do të ketë vërejtje nga ana juaj, ftoj stafin të shortoje edhe këtë kërkesë.

Ilir Rusi: Faleminderit i nderuar relator!

Ka diskutime nga anëtarët prezent në mbledhje për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime).

Meqenëse nuk ka diskutime, ftoj stafin për hedhjen e shortit.

Vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për kërkesën 145, gjyqtarë të përzgjedhur Mikel Hysometaj dhe Entiljano Spahiu.

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Me hedhjen e shortit dhe relatimet përkatëse, mbledhje e deklarohet të mbyllur.

Mbasdite të qetë.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor